



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, të nenit 17 të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohëshme në pronen publike 15Nr.011-5823 të datës 01.02.2016 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË PLANIT PËR
VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHËSHME NË PRONËN PUBLIKE

Neni 1

Formimi i grupit punues dhe përbërja

Me këtë Vendim formohet grupi punues për hartimin e projektit të planit për vendosjen e objekteve të përkohëshme në pronen publike në këtë përbërje:

1. Bajram Sinani, Kryesues, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
2. Ilir Shala, anëtar, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër
3. Behar Krasniqi, anëtar, Zyra e Kryetarit, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore
4. Kushtrim Salihu, anëtar, Drejtorati për Shërbime Publike
5. Jeton Zymeri, anëtar, Zyra e Kryetarit, Sektori pronësor-juridik

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues

Detyrë e Grupit punues është hartimi i Planit për vendosjen e objekteve të përkohëshme në pronën publike për tërë teritorin e Komunës së Lipjanit në bazë të detyrës projektuese të cilën e përgatit Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në pajtim me 17 të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohëshme në pronen publike 15Nr.011-5823 të datës 01.02.2016 dhe dispozitat ligjore përkatëse.

Grupi punues projektin e Planit të cekur duhet të hartoj më së largu deri më datën 01.03.2017.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Grupit punues.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi 1Nr. 464-9215 i datës 24.02.2016.

1Nr. 351-2969
Lipjan, më 24.01.2017

